

Jetëshkrim

Z. Gledis Gjipali është zgjedhur Anëtar i Autoritetit të Mediave Audiovizive me Vendim të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, nr. 74/2014, datë 09 Tetor 2014.

Z. Gjipali është diplomuar në Fakultetin e Drejtësisë në Universitetin e Tiranës në vitin 2004. Ai ka punuar për disa vite në Ministrinë e Integritit European (2004 -2008), fillimisht në Drejtorinë e Përafrimit të Legjislacionit, duke u marrë ekskluzivisht me përafrimin e legjislacionit të BE -së në fushën e emigracionit, azilit, krimit të organizuar, bashkëpunimit gjyqësor, drejtave të njeriut, politikave audiovizuale, dhe mbrojtjes së të dhënave personale. Më vonë ai iu bashkua Drejtorisë së Drejtësisë dhe Çështjeve të Brendshme, ku u angazhua me reformën në sistemin gjyqësor, të drejtat e pronësisë si dhe mbrojtjen e të dhënave personale.

Gledis Gjipali në 2008 iu bashkua organizatës Lëvizja Europiane në Shqipëri (pjesë e Lëvizjes Europiane Ndërkombëtare) dhe e udhëheq atë që prej vitit 2009. Kjo organizatë është themeluar në vitin 2007 si përgjigje ndaj përpjekjeve në rritje të Shqipërisë për të avancuar në procesin e integritit European.

Z. Gjipali ka botuar disa studime dhe raporte në fushën e Integritit European, lëvizjes së lirë të personave, ndihmës së BE-së në zhvillimin rajonal dhe rural, sistemeve zgjedhore dhe parlamentit. Z. Gjipali për 5 vjet, që prej vitit 2009 ka qenë autori i raportit Vende në Tranzicion të Freedom House për Shqipërinë. Ai është pjesë e Këshillit Kombëtar të Integritit European si dhe Konventës të Integritit European.

Ai flet Shqip (gjuha amtare), Anglisht dhe Italisht.